



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:291952

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05445442

C.nr.494/2019

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, si civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Hajrullah Aruqi, duke vendosur në çështjen juridike te paditëses B... me seli në Prishtinë, kundër te paditurit T.V., nga fshati..., komuna Skenderaj, në çështjen juridike kontestimore, rimbursim dëmi, pas përfundimit të seancës gjyqësore me dt.21.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet se paditësja B... me seli në Prishtinë, e ka tërhequr padinë kundër të paditurit T.V., nga fshati..., komuna Skenderaj, në çështjen juridike kontestimore, rimbursim dëmi, në lëndën.C.nr.494/2019.

A r s y e t i m

Paditësja B..., me seli në Prishtinë, Rr..., ka ushtruar padi në këtë gjykatë për çështjen juridike rimbursim dëmi, kundër te paditurit T.V., nga fshati..., në të cilën ka theksuar se tani i padituri me datë 04.02.2019, në ora 17:40 me automjetin VW me targa të regjistrimit... ka shkaktuar aksident trafikun në Skenderaj, me ç'rast automjeti me të cilin i padituri e voziste, ka shkaktuar dëme X... Shpk në Skenderaj. Andaj ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpapia e paditësit B..., të aprovohet në tersi si e bazuar, dhe të detyrohet i padituri që paditësit të ia kompensoj shumën prej 620.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 04.02.2019, në Skenderaj.

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike përmes aktvendimit të datës 26.11.2023 e ka detyruar të paditurin T.V. të jep përgjigje në padi ashtu që të deklarohet lidhur me pretendimet e paditëses në padi, mirëpo gjykata nuk pati mundësi dërgimin e aktvendimit të paditurit pasi që nga fletë kthesa e dt. 10.01.2024 konstatohet se i padituri është shpërngulur jashtë vendi në adresë të panjohur.

Gjykata për këto arsye ka caktuar shqyrtimin gjyqësor për datë 21.02.2024, megjithatë në këtë shqyrtim për paditësen nuk ishte prezent askush, nga shkresat e lëndës është konstatuar se është thirrë me rregull me datë 30.01.2023, mospjesëmarrjen për seancë nuk e kanë arsyetuar.

Gjykata duke i marrë parasysh të gjitha të lartë cekurat i zbatoi dispozitat e nenit 409 par.1 te LPK-se ku parashihet se *‘Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse*

është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet, në rastin konkret gjykata vlerëson se janë të plotësuara kushtet ligjore sipas dispozitës ligjore të përmendur më lartë nga se paditësja ka qenë e thirrur me rregull për shqyrtimin e datës 21.02.2024 ndërsa mos prezencën në seancë nuk e ka paralajmëruar e as arsyetuar, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me sa u tha me lartë komfor dispozitave te nenit 142 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.494/2019, me dt.21.02.2024

Gj y q t a r i
Hajrullah Aruqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit te aktvendimit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.